



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRI

Bulevardi "Bajram Curri" Tiranë, Albania - Tel/Faks. +355 4 362937 - www.msh.gov.al

Nr. 143 Prot.

Tiranë, më 2 2008

URDHËR

Nr. 143 Datë 2.12.2008

P Ë R

**PAJISJEN E PERSONAVE TË DHUNUAR NË MARRËDHËNIET
FAMILJARE ME RAPORTIN MJEKSOR PËRKATËS**

Në mbështetje të nenit 4, të pikës 102 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2.ç të Ligjit nr. 9609, datë 18.12.2006, " Për parandalimin e dhunës në familje" **me qëllim**, pajisjen e viktimave të dhunës në familje me raportin e përkatës mjekësor.


URDHËROJ:

1. Çdo person i dhunuar në marrëdhëniet familjare, që merr trajtimin diagnostikues dhe mjekues në institucionin shëndetësor publik, të pajiset me raportin përkatës mjekësor.
2. Çdo veprim diagnostikues e mjekues që personeli shëndetësor kryen ndaj personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare, të regjistrohet në regjistrin për evidentimin e viktimave të dhunës në familje dhe kartelën individuale për viktimat e dhunës në familje.
3. Mjeku, në raportin përkatës të informojë viktimën për diagnozën, egzaminimet, trajtimet e kryera si dhe këshillimet dhe referimet që i janë ofruar viktimës së dhunës në familje.

4. Personeli i institucioneve shëndetësore publike nuk duhet të refuzojë për të dhënë ndihmën urgjente për çdo të dhunuar në familje në çdo vend e rrethanë. Me kërkesën e viktimës, ai duhet ta pajisë të dhunuarit me raportin e përkatës mjeksor, pavarësisht nga specialiteti që ai ka.
5. Modeli i raportit përkatës mjeksor për viktimat e dhunës në familje hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Planifikimit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë
6. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe e Planifikimit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë si dhe Drejtoritë e Shëndetit Publik në Rrethe.
7. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

NARD NDOKA



4. Personeli i institucioneve shëndetësore publike nuk duhet të refuzojë për të dhënë ndihmën urgjente për çdo të dhunuar në familje në çdo vend e rrethanë. Me kërkesën e viktimës, ai duhet ta pajisë të dhunuarin me raportin e përkatës mjeksor, pavarësisht nga specialiteti që ai ka.
5. Modeli i raportit përkatës mjeksor për viktimat e dhunës në familje hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Planifikimit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë
6. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe e Planifikimit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë si dhe Drejtoritë e Shëndetit Publik në Rrethe.
7. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

NARD NDOKA

